



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 479/9 prot.

Datë 17.03.2026

V E N D I M

Nr. 401/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EXTRABIS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72416-12-16-2025, me objekt Loti i I - “Blerje uniforma dhe veshje speciale – uniformë zjarrduruese” me fond limit: 27,880,050.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “EXTRABIS” SHPK me NIPT L22218008Q dhe adresë: *Kati i Trete, Godina ZDS , Rruga Dytesore Tirane - Durres, Km.5, Mezez, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë me adresë: *Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.12.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72416-12-16-2025, me objekt Loti i I - “Blerje uniforma dhe veshje speciale – uniformë zjarrduruese” me fond limit: 27,880,050.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 27.01.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 12.02.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- BOE “D&E” dhe “Victoria-AL” SHPK	20,850,000.00 lekë	kualifikuar
-“Muhoplus ltd” SHPK	20,913,000.00 lekë	kualifikuar

- BOE “Gentian Sadiku” P.F, & “Univers Promotions” SHPK	23,670,000.00 lekë	Skualifikuar
- “Extrabis” SHPK	23,775,000.00 lekë	skualifikuar
- “Malbertex” SHPK	26,250,000.00 lekë	kualifikuar
- Iberlina Hadja P.F	27,750,000.00 lekë	skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se nuk është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak.

II.5. Në datën 15.02.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6329 dhe me nr. 479/2026 prot., datë 16.02.2026 e operatorit ekonomik “EXTRABIS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72416-12-16-2025, me objekt Loti i I - “Blerje uniforma dhe veshje speciale – uniformë zjarrduruese” me fond limit: 27,880,050.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EXTRABIS” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 479/1 prot., datë 16.02.2026.

II.7. Përmes shkresës me nr. 7474/2 prot., datë 06.03.2026 me lëndë “ Informacion lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EXTRABIS” SHPK protokolluar me tonën me nr. 479/3 prot., datë 09.03.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP informacion lidhur me ankesën e sipërcituar nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës duke u shprehur:

“Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, pasi u njoh me ankesën nr. A/2026/6329 me Nr. Prot. 479/2026 të operatorit ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, ne respektim te dispozitave të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) neni 112 si dhe VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" (i ndryshuar) neni 96, vendosi pezullimin e procedures së prokurimit me objekt: "Loti i I - Blerje uniforma dhe veshje special-uniforme zjarrduruese"

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, referuar Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik i (ndryshuar)" Neni 111 si dhe VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) neni 94, ku percaktohet se "Ankimuesi eshte i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën" Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë konstatoi se në sistemin e ankesave elektroknike të KPP-së, operatori ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k nuk ka bërë pagesë për tarifën e ankesës.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, më datë 23.02.2026, njoftoi nëpërmjet komunikimit elektronik (email) operatorin ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, per plotesimin e elementeve të ankesës, konkretisht pagesës se tarifes ne perputhje me kërkesat e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" (i ndryshuar) neni 94, pika 5, ku përcaktohet se: "Ankesa duhet te korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. Nëse ankesa nuk korigjohet/plotësohet brënda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur".

Per me sipër, ju informojme se ankesa vazhdon te qëndroje me statusin "Pa paguar" dhe për këtë arsye u konsiderua e paparaqitur dhe nuk u trajtua nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave (KSHA) pasi edhe pas njoftimit te Autoritetit Kontraktor, operatori ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, nuk ka bere korigjimet perkatese ne lidhje me pagesen e tarifes.

Bashkëlidhur ju dergojme per informacion dokumentacionin e mëposhtem:

- Njoftimin email derguar ankimuesit;
- Procesverbal i dates 02.03.2026, mbatur nga Komisioni Shqyrtimit te Ankesave"

II.8. Me shkresën nr. 8955/1 prot., datë 11.03.2026 me lëndë "Kthim përgjigje" protokolluar me tonën me nr. 479/4 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar KPP se në përgjigje të shkresës së këtij të fundit me nr. 479/2 prot., datë 02.03.2026 drejtuar autoritetit kontraktor, ai ka ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe vendimi i marrë nga ana e KSHA është vënë në dispozicion të KPP dhe operatorit ekonomik me anë të shkresës me nr. 7474/2 prot., datë 06.03.2026. Bashkëlidhur saj gjendet shkresa me nr. 7474/2 prot., datë 06.03.2026 e autoritetit kontraktor drejtuar KPP si dhe shkresa me nr. 479/2 prot., datë 02.03.2026 e KPP drejtuar autoritetit kontraktor.

II.9. Përmes memos me nr.479/5 prot., datë 17.03.2026, KPP ju drejtua Sektorit të Finances, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve të institucionit me qëllim verifikimin e statusit të pagesës së operatorit ekonomik "Extrabis" SHPK me përmbajtje si vijon:

"Në datën 15.02.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6329 dhe me nr. 479/2026 prot., datë 16.02.2026 e operatorit ekonomik "EXTRABIS" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-72416-12-16-2025, me objekt Loti i I - "Blerje uniforma dhe veshje speciale – uniformë zjarrduruese" me fond limit: 27,880,050.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër ankimi A/2026/6329 dhe me nr. 479/2026 prot., datë 16.02.2026 rezulton "pa paguar".

Sa më sipër me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën e sipërpërmendur."

II.10. Në përgjigje të kërkesës më sipër, Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve përmes shkresës me nr. 479/6 prot., datë 17.03.2026 ka njoftuar KPP si vijon: "Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 479/5 prot., datë 17.03.2026, me lëndë "Kërkesë për verifikim pagese", ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 479/2025 prot., 16.02.2026 me numër ankimi elektronik A/2026/6329, Operatori ekonomik "EXTRABIS" Shpk nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimit.

Referuar kërkesës tuaj, janë kryer verifikime me raportin e dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera gjatë muajt Shkurt, rezulton se Operatori Ekonomik “EXTRABIS” Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

II.11. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente në sistemin e ankesave elektronike nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të *lex specialis*.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Extrabis” SHPK në datën 15.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, me numër ankimi elektronik A/2026/6329 dhe me nr. 479/2026 prot., datë 16.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72416-12-16-2025, me objekt Loti i I - “Blerje uniforma dhe veshje speciale – uniformë zjarrduruese” me fond limit: 27,880,050.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, KPP konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.
2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësismit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Përmes shkresës me nr. 7474/2 prot., datë 06.03.2026 me lëndë “ Informacion lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EXTRABIS” SHPK protokolluar me tonën me nr. 479/3 prot., datë 09.03.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP informacion lidhur me ankesën e sipërcituar nga ku rezulton, se ka vendosur mos pranimin e ankesës duke u shprehur:

“Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, pasi u njoh me ankesën nr. A/2026/6329 me Nr. Prot. 479/2026 të operatorit ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, ne respektim te dispozitave të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) neni 112 si dhe VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" (i ndryshuar) neni 96, vendosi pezullimin e procedures së prokurimit me objekt: "Loti i I - Blerje uniforma dhe veshje special-uniforme zjarrduruese"

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, referuar Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik i (ndryshuar)" Nenit 111 si dhe VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) neni 94, ku percaktohet se "Ankimuesi eshte i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës perkatëse për ankesën" Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë konstatoi se në sistemin e ankesave elektrokniqe të KPP-së, operatori ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k nuk ka bërë pagesë për tarifën e ankesës.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, më datë 23.02.2026, njoftoi nëpërmjet komunikimit elektronik (email) operatorin ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, per plotesimin e elementeve të ankesës, konkretisht pagesës se tarifës ne perputhje me kërkesat e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" (i ndryshuar) neni 94, pika 5, ku përcaktohet se: "Ankesa duhet te korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. Nëse ankesa nuk korigjohet/plotësohet brënda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur".

Per me sipër, ju informojme se ankesa vazhdon te qëndroje me statusin "Pa paguar" dhe për këtë arsye u konsiderua e paparaqitur dhe nuk u trajtua nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave (KSHA) pasi edhe pas njoftimit te Autoritetit Kontraktor, operatori ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, nuk ka bere korigjimet perkatese ne lidhje me pagesen e tarifës.

Bashkëlidhur ju dergojme per informacion dokumentacionin e mëposhtem:

- Njoftimin email derguar ankimuesit;*
- Procesverbal i dates 02.03.2026, mbatur nga Komisioni Shyrtimit te Ankesave”*

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të

LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë *apriori*, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP me shkresën me nr. 7474/2 prot., datë 06.03.2026 me lëndë *"Informacion lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "EXTRABIS" SHPK"* protokolluar me tonën me nr. 479/3 prot., datë 09.03.2026 rezulton, se autoriteti kontraktor edhe pse nuk ka dokumentuar bashkëngjitur shkresë së sipërcituar komunikimin me ankimuesin lidhur me plotesimin e elementeve të ankesës, konkretisht pagesës se tarifës ne perputhje me kërkesat e nenit 94, pika 5 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, por është shprehur në mënyrë narrative në shkresë se i ka zbatuar këto hapa, KPP gjykon se përgjegjësia mbi çdo informacion të paraqitur bie mbi vetë autoritetin kontraktor dhe në këtë kuptim do t'i konsiderojë si të zbatuara nga ana e tij përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis*, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit në mënyrë narrative në shkresë (pa dokument provues bashkëngjitur) shprehet se përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) më datë 23.02.2026 e ka njoftuar ankimuesin mbi korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës, nga ku sipas tij edhe pas njoftimit, operatori ekonomik "EXTRABIS" sh.p.k, nuk ka bërë korrigjimet përkatëse në lidhje me pagesën e tarifës. Gjithashtu përmes shkresës me nr. 479/6 prot., datë 17.03.2026, Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në KPP ka informuar se: *"Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 479/5 prot., datë 17.03.2026, me lëndë "Kërkesë për verifikim pagese", ju bëjmë me dije se për ankesën me nr. 479/2025 prot., 16.02.2026 me numër ankimi elektronik A/2026/6329, Operatori ekonomik "EXTRABIS" Shpk nuk ka paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.*

Referuar kërkesës tuaj, janë kryer verifikime me raportin e dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera gjatë muajt Shkurt, rezulton se Operatori Ekonomik "EXTRABIS" Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar."

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje më përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Extrabis” SHPK pranë Komisionit Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Gjithashtu KPP vëren se ankesa e operatorit ekonomik “Extrabis” SHPK nuk ka plotësuar edhe kushtet formale për sa i përket legjitimit kohor në kuptim të pikës 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Në rastin konkret ankimuesi “Extrabis” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike njëherazi në KPP dhe autoritet kontraktor me datë 15.02.2026, ndërkohë sipas verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, rezulton se akoma nuk është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për këtë procedurë prokurimi, moment nga i cili duhet të fillojnë edhe afatet e ankimit për operatorët ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar pasi në datë 15.02.2026 (data që ankimuesi ka paraqitur ankesën në sistemin e ankesave elektronike njëherazi në KPP dhe autoritet kontraktor) nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Në rastin konkret, në datë 15.02.2026 afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, që do të thotë se ankimuesit nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Ankesa e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dhe autoritetin kontraktor në datë 15.02.2026, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Extrabis” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72416-12-16-2025, me objekt Loti i I - “Blerje uniforma dhe veshje speciale – uniforme zjarrduruese” me fond limit: 27,880,050.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

